



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI

Nr. 1865 prot.

Vlorë, më 21.02 2020

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, _____ 2020

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE”.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9.1 pika 1/a, dhe b, Neni 54 pika a, neni 70 dhe 71 Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27 shkurt 2020 pasi shqyrtoi Projektin e propozuar nga grupi i punës” Për Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të strukturave komunitare në fshat,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të strukturave komunitare në fshat
2. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55 pika 6.

KRYETARE

Migena Balla



Konceptoi: A. Gjipali



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI**

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421207; Fax 033 421207; www.vlora.gov.al; E-mail:
info@vlora.gov.al

Nr. prot

Vlorë, .

**RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS
KOMUNITARE NË FSHAT**

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

QËLLIMI

Për organizimin dhe funksionimin efikas të strukturave komunitare në fshat , me qëllim që qytetarët të kenë mundësinë e realizimit të të drejtave të tyre në të gjitha fushat sipas ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

NENI 2.

MANDATI I KRYESISË DHE KRYETARIT:

- Zgjedhjet e kryesisë së fshatit bëhen 1 herë në 4 vjet. Ato zhvillohen menjëherë pas mbarimit të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë, por jo më vonë se tre muaj nga konstituimi i këshillit.

- Mandati i kryesisë dhe kryetarit të fshatit përfundon me kryerjen e periudhës së afatit 4 vjeçar.
- Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, Kryetari i Bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit.

NENI 3.

STRUKTURA NË FSHAT.

Bashkia Vlorë ka 4 Njësi Administrative Orikum, Qendër, Novoselë dhe Shushicë.

- **NJ.Adm. ORIKUM** ka 4 fshatra : Dukat fshat, Dukat fushë, Tragjas dhe Radhimë.
- **NJ.Adm. QENDËR** ka 11 fshatra : Bestrovë, Babicë e madhe, Babicë e vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë Sherishtë, Panaja, Xhuherinë dhe Zvërnec.
- **NJ.Adm. NOVOSELË** ka 12 fshatra: Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllënjë, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofo tinë, Fitore Delisuf dhe Akërni
- **NJ.Adm. SHUSHICË** ka 9 fshatra: Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat dhe Risili

NENI 4

PËRBËRJA , KRITERET DHE NUMRI I PËRFAQËSUESVE NË KRYESI.

- Fshati si strukturë drejtohet nga kryetari dhe kryesia.
- Kryesia e fshatit është organ këshillimor.
- Në mbledhjen e fshatit zgjidhen anëtarët e kryesisë .

- Për të kryer funksionet kryesia, rekomandohet që anëtarët e saj të jenë me arsim të lartë dhe në pamundësi me arsim të mesëm.
- Për zgjedhjen e tyre këshilli duhet të miratojë disa kritere strikte për integritetin dhe figurën morale. Nuk duhet të jenë njerëz që kanë kryer krime apo që manifestojnë figurë të ulët morale.
- Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga Këshilli i Bashkisë.
- Përbërja në kryesitë e fshatrave të respektojë barazinë gjinore dhe pakicat etnike.
- Këshilli për të përcaktuar numrin e përfaqësimit në fshatra merr vendim.
- Në fshatrat me mbi 2000 banorë të zgjidhen 5 përfaqësues.
- Në fshatrat me nën 2000 banorë të zgjidhen 3 përfaqësues.
- Para se të organizohen zgjedhjet në fshatra këshilli të miratojë hartat sipas lagjeve dhe ndarjeve me 3 ose 5 anëtarë.
- Zgjedhjet e kryesisë bëhen të hapura mbi bazë lagje dhe fiton kush merr numrin më të madh nga votuesit në lagje, por gjithmonë kush merr më shumë se 50 përqind e numrit të përgjithshëm të banorëve në fshat.
- Hapjen e mbledhjeve në lagje e bën kryesuesi ose drejtuesi i grupit të këshilltarëve caktuar me vendim nga këshilli i bashkisë.

NENI 5

ZGJEDHJA E KRYESISË DHE E KRYETARIT

- Kryetari i fshatit në detyrë në bashkëpunim me këshillin e bashkisë dhe kryetarin e njësisë administrative formojnë një komision për organizimin e procedurës së zgjedhjeve dhe votimeve. Në përbërje të këtij komisioni të të jenë 3-5 anëtarë sipas miratimit të rregullores së organizimit dhe funksionimit të strukturave komunitare në fshat.
- Komisioni pas kryerjes së votimit shpall fituesit për anëtarë kryesie mbi bazë lagjesh .
- Në votim duhet të jenë pjesëmarrës më shumë se 50 përqind e numërit të përgjithshëm të banorëve që jetojnë në fshat me të ndrejtë vote(18 vjeç e lart.)
- Nëse në votimin e parë për anëtarin e kryesisë ose kryetarin e fshatit asnjë kandidat nuk ka fituar numërin e caktuar sipas detyrimit

ligjor, organizohet një votim i dytë midis 2 kandidatëve që kanë fituar më shumë vota.

- Zgjedhjet për kryetarin zhvillohen në mjedis të mbyllur mbi bazën e propozimit të anëtarëve të kryesisë. Kandidati që merr më shumë vota zgjidhet automatikisht kryetar i kryesisë së fshatit.
- Pas kryerjes së votimeve, me zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarit të fshatit, lista emërore menjëherë i përcillet sekretarit të këshillit me emër, mbiemër dhe nr .e kontaktit për secilin prej të zgjedhurve.

NENI 6

PËRFAQËSIMI NË KRYESINË E FSHATIT

*Përfaqësimi i partive politike në kryesi mundësisht të jetë proporcionale në raport me zgjedhjet vendore për fshatin përkatës. Nuk përjashtohet që fshati mund të propozojë edhe përfaqësues nga shoqëria civile ,njerëz me profil të lartë dhe me integritet.

NENI 7

SHKARKIMI I ANËTARIT TË KRYESISË OSE KRYETARIT

- Shkarkimi i anëtarit të kryesisë ose kryetarit bëhet sipas procedurës të njëjtë që është bërë për zgjedhjen e tyre në fshat.
- Shkarkimi i kryetarit të kryesisë të fshatit ndodh në këto raste:
- Me rastin e paraqitjes së dorëheqjes,
- Me rastin e vdekjes,
- Me rastin e ndërrimit të vendbanimit,
- Me rastin e inicimit të mocionit të mosbesimit nga 2/3 e anëtarëve të kryesisë mocion i cili duhet të jetë i motivuar dhe i pranuar nga Këshilli i Bashkisë
- Me propozim të Këshillit të Bashkisë ose Kryetarit të Bashkisë për punë jo të mirë që bie ndesh me kërkesat e komunitetit dhe ligjet e shtetit.

NENI 8

MONITORIMI I ZGJEDHJEVE NGA KËSHILLI I BASHKISË

- Këshilli i Bashkisë zgjedh një këshill kordinimi ose komision me përfaqësues nga të gjitha grupet për monitorimin e zgjedhjeve në çdo njësi administrative dhe fshat.
- Këshilli krijon grupet e monitorimit sipas përbërjes së subjekteve kryesore për çdo fshat me jo më pak se tre veta .
- Këto grupe bashkëpunojnë me njësinë administrative, kryetarët e fshatrave në detyrë dhe janë përgjegjës për zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarit të fshatit.
- Këshilli kordinues ose komisioni përgjegjës në krye të tij duhet të ketë një drejtues të miratuar nga këshilli .

NENI 9

ORGANIZIMI DHE NJOFTIMI PËR KRYESITË

- Këshilli dhe Njësia administrative njoftojnë 15 ditë para zgjedhjeve banorët dhe kryetarin e fshatit në detyrë dhe udhëzojnë:
- Të vendosen shpallje publike në objekte publike dhe vende të frekuentuara brenda territorit të fshatit ku organizohen zgjedhjet.
- Njoftimi i publikut duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes .
- Të njoftohen nga Këshilli i Bashkisë dhe administrata mediat e shkruara dhe elektronike

NENI 10

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

- Të mbahet një libër procesverbalesh për çdo njësi administrative me qëllim pasqyrimin e çdo mbledhje të fshatrave të kësaj njësie ku të pasqyrohet numri i qytetarëve që marrin pjesë në votim, kush diskuton, forma dhe procedura e votimit.
- Librat e procesverbaleve do të ruhen si dokument zyrtar së bashku me praktikën e zgjedhjeve në dosje të veçanta për çdo njësi.
- Procesverbali duhet të përshkruaj numrin e banorëve pjesëmarrës në mbledhje, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë në lagje, emrat e mbiemrat me votat e marra për secilin konkures dhe fitues.
- Procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi i protokollit, grupi monitorues i këshillit, përfaqësuesi i njësisë si dhe kryetari i fshatit i sapozgjedhur.
- Grupi monitorues përgatit me shkrim një informacion për mbledhjen dhe ia dorëzon kryesisë së këshillit të bashkisë Vlorë së bashku me procesverbalet e mbajtura.

NENI 11

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYESISË SË FSHATIT.

Kryesia e fshatit ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë si më poshtë:

- Mbështet programin dhe projektet e bashkisë në fshat.
- Interesohet dhe synon zhvillimin dhe përparimin e fshatit.
- Kujdeset për normat dhe harmoninë sociale në fshat.
- Interesohet për sigurinë ushqimore në fshat.
- Merr masa për mbrojtjen nga zjarri
- Parandalon ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e ujësjellësit, të kanalizimeve dhe ujërave të ndotura.
- Mirëmbajnë rrjetin e ujitjes dhe kullimit dhe atë rrugor dhe rural.
- Mirëmbajnë sheshet, trotualet ku ekzistojnë dhe mjediset e gjelbëruara.
- Kujdesen për mirëmbajtjen e pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore.
- Bashkëpunon me njësinë administrative për interesat dhe investimet në fshat.

- Dërgon prioritetet e fshatit në njësi dhe bashki për çdo vit para miratimit të buxhetit të bashkisë.
- Menaxhon mbetjet në fshat.
- Interesohet për kujdesin e shërbimit parësor.
- Organizon veprimtari dhe aksione vullnetare që i shërbejnë fshatit .
- Siguron të dhënat elementare për çdo familje në fshat dhe përcjell gjendjen e tyre të vështirë ekonomike në drejtorinë e ndihmës dhe përkrahjes sociale në bashki.
- Brenda mundësive dhe drejtimit ekonomik të fshatit promovon traditat në kulinari e turizëm zhvillon veprimtari kulturoro-artistike në fshat etj.
- Jep rekomandime dhe kërkon ndihmë në bashki për familjet në nevojë .
- Kryesia e fshatit përgatit dhe i drejton pyetje me shkrim këshillit dhe njësisë administrative për probleme të ndryshme të tij , i cili brenda një muaji është i detyruar tu kthejë përgjigje.
- Kryesia e fshatit ka të drejtë të thërrasë në mbledhje me banorët e vet ,drejtues të bashkisë si dhe këshillit për probleme shqetësuese ose emergjente.

NENI 12

DETYRAT E KRYETARIT TË KRYESISË

- Kryetari i kryesisë së fshatit përfaqëson fshatin në konsultimet dhe diskutimet në Njësi dhe Bashki.
- Kryetari i fshatit thërret kryesinë dhe drejton mbledhjen.
- Mban procesverbal në mbledhjet e mbajtura.
- Nënshkruan propozimet e dala në kryesi dhe njofton njësinë dhe bashkinë .
- Interesohet dhe ndërhyt për problemet e higjenës dhe mjedisit në fshat.
- Kryetari mban lidhje me bashkinë dhe këshillin,me institucionet si oshe,drejtorinë e policisë,drejtorinë e kullotave,sigurimet shoqërore ,shëndetësinë etj.
- Kryetari njofton zjarrfikëset dhe Bashkinë në rastet e rënies së zjarreve.

- Kryetari i fshatit së bashku me drejtorinë e kullotave ndajnë sipërfaqet kullimore duke i vënë detyrë çdo bariu në zonë që të mbajë përgjegjësi për rënien e zjarrit.
- Ai në raport me njësinë administrative zbaton VKB dhe njofton për zënien e hapësirave publike.
- Kontrollon ,verifikon dhe njofton në Njësinë administrative për ndërtimet pa leje
- Kryetari dhe kryesia kujdesen për mirëmbajtjen e rrugës kryesore që lidh fshatin me qytetin , rrugët e lagjeve dhe kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore.
- Ai përgjigjet për ruajtjen e kullotave nga zaptuesit. Dhe administrimin e burimeve natyrore që gjenden në territorin e fshatit.
- Kryetari dhe kryesia kujdesen për furnizimin me ujë të pishëm për banorët e fshatit,sistemin e furnizimit me ujë nga stacioni i pompimit të fshatit,linja e transmentimit,depua e grumbullimit si dhe rjeti shpërndarës brenda fshatit.
- Kryetari dhe kryesia kujdesen për ndriçimin e rrugëve dhe shesheve të fshatit.
- Kryetarikujdeset së bashku me kryesinë për vend depozitimin e mbeturinave dhe për pastrimin e fshatit.
- Ai me kryesinë kujdeset për kanalizimin e ujërave të zeza dhe mirëmbajtjen higjieno sanitare të gropave septike.
- Kryetari dhe kryesia marrin vendime për lirim e rrugëve bujqësore,kullotave,vendpërcaktimin e mbeturinave si dhe hapësirat e lëna në dispozicion për varrezat e fshatit.
- Kryetari përgjigjet ligjërisht kur sheh që në territorin e fshatit është mbjellë lëndë narkotike dhe nuk njofton.
- Nuk lejon që të priten drurët dhe pemët.
- Ai mban lidhje me DAMT për problemet që lindin për tokat bujqësore në fshat.
- Kryetari ndërhyt dhe zgjidh konfliktet dhe problemet pronësore në fshat.
- Kryetari i kryesisë së fshatit merr me procesverbal vulën e fshatit dhe e dorëzon atje ku ka marrë me procesverbal.
- Kryetari i fshatit të dokumentojë personalisht çdo kërkesë,vërtetim apo vendim të dhënë duke specifikuar datën e dhënies,muajin dhe vitin për arsye se kërkohet nga disa institucione origjina dhe koha e dhënies së dokumentit.

- Lëshon vërtetime për ZVRPP dhe bën shpalljen 45 ditore të vërtetimit të tokave me qëllim nëse ka konflikt apo jo kjo pronë me ndonjë qytetar tjetër. Ky dokument zyrtar firmoset nga kryetari i fshatit.
- Kryetari i fshatit shpërblehet për detyrën që kryhen me 10 përqind të rrogës së kryetarit të njësisë administrative përkatëse.

NENI 13

MARRËDHËNIET E KRYETARIT TË FSHATIT ME KËSHILLIN

- Kryetari i fshatit i raporton çdo muaj me shkrim Njësisë dhe Këshillit të Bashkisë për punën e kryer dhe kërkesat e banorëve.
- Këshilli në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë organizon 3-4 takime në vit me kryetarët e kryesive për problemet dhe shqetësimet e komunitetit duke orjentuar dhe përcaktuar detyra për funksionimin me efektivitet të tyre.
- Në rastet kur për arsye pune ose shëndeti kryetari i fshatit largohet për një periudhë mbi 1 muaj brenda ose jashtë vendit, ai vë në dijeni sekretarin e këshillit dhe Njësinë administrative.
- Vendimet dhe urdhërat e nxjerra nga këshilli dhe Kryetari i Bashkisë janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari i fshatit.
- Këshilli mund të thërrasë një ose disa kryetarë brenda njësisë për probleme specifike të territorit dhe banorëve. Secili kryetar fshati me iniciativë të tij mund të marrë pjesë dhe diskutojë në çdo mbledhje të këshillit për problemet e komunitetit që ai i quan të nevojshme.

NENI 14

MARRËDHËNIET E KËSHILLIT TË BASHKISË ME KRYESITË

Këshilli ngre një komision performance për realizimin e detyrave nga kryesitë e fshatrave për:

- Për prioritetet e punës së tyre.
- Për ruajtjen e mjedisit dhe higjenës.
- Për evidentimin dhe përgjithësimin e përvojës në fshat.
- Për zgjidhjen e problemeve të banorëve.
- Për pjesëmarrje në vendimmarrje të tyre nëpërmjet diskutimeve,debateve,konsultimeve etj.
- Për besimin e komunitetit te njësia administrative dhe bashkia.

Mbi bazën e problematikave të hasura këshilli harton një raport 1 herë në 6 muaj dhe ia paraqet këshillit i cili rekomandon detyra dhe nxjerr përgjegjësitë

NENI 15

KRYESIA E FSHATIT DHE MJETET E KONSULTIMIT

Kryesia në bashkëpunim me këshillin, organizon konsulta për projekt vendimet që kanë lidhje me fshatin,për shqetësimet dhe problemet e saj.

Mjetet e konsultimit janë:

- Mbledhjet në lagje ose fshat me grupet e interesit sipas problematikave.
- Thirrja e televizioneve lokale në bashkëpunim me Këshillin e Bashkisë.
- Mediat sociale si web i bashkisë,watssap etj.
- Postera të vendosur në fshat dhe në njësinë administrative.
- Aplikim online psh për buxhetin e fshatit dhe njësisë ku jepet mendim për projektbuxhetin dhe mendimet e banorëve për prioritetet e fshatit.
- Të intesifikohet puna me ato grupe që nuk marrin pjesë në konsultime të tilla si gratë fermere,gratë e veja,gratë nga pakicat etnike etj.

NENI 16

MARRËDHËNIET E KRYETARIT ME POLICINË E SHTETIT

- Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në fshat kërkohet bashkëpunimi dhe informimi i ndërsjellë me policinë e shtetit.
- Kryetari duhet të afishojë në fshat numrat e kontaktit të policisë së shtetit dhe policisë bashkiake.
- Për zjarrëvënje të qëllimshme në kullota, për cënim të pronës dhe jetës kryetari i fshatit sinjalizon menjëherë shërbimin policor.
- Bashkëpunon me policinë e shtetit për raste të rahjeve dhe grindjeve që kanë tendencë agravimi.

NENI 17

MARRËDHËNIET E KRYETARIT ME POLICINË BASHKIAKE

Kryetari i fshatit komunikon me Policinë Bashkiake për këto probleme:

- Kur ka probleme emergjence si përmbytje, zjarre,
- Kur ka ndërtime pa leje në fshat.
- Në rastet kur pengohet zbatimi i një urdhi apo investimi të bashkisë
- Në rastet e zaptimit të pronës publike si varreza etj

NUMRI I KONTAKTIT ME POLICINË BASHKIAKE 033404404.

NENI 18

MARRËDHËNIET E KRYETARIT ME NJËSINË ADMINISTRATIVE.

- Kryetari i kryesisë së fshatit mban raporte komunikimi të vazhdueshme për:
- Zënien e hapësirave publike.
- Për problemet e ujit të pishëm
- Për ndriçimin rrugor.
- Për pastrimin e territorit të fshatit
- Për prioritetet e fshatit për buxhetin .
- Kontrollon dhe njofton njësinë administrative për ndërtimet pa leje.
- Njofton njësinë për djegiet e kullotave në afërsi të fshatit.

- Për djegie transformatorësh ose ndërprerjes së energjisë elektrike në fshat.

NENI 19

PËRDORIMI I VULËS

- Kryetari pajiset me vulë dhe ka autoritetin të japë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose fshatin e tij, për të cilat ka dijeni të plotë dhe është përgjegjës para ligjit.
- Shteti për tu ardhur në ndihmë fermerëve bën rimbursime për shtimin e bagëtive, sipërfaqeve të vreshtave, ullinjve e drurëve frutorë për të cilat kërkohet nënshkrimi dhe vula e kryetarit të fshatit ndaj kërkohet bashkëveprimi me agronomin dhe veterinerin e njësisë duke i verifikuar në vend sasinë e tyre.
- Vazhdimisht Drejtoria e Bujqësisë nën drejtimin e zyrës veterinare të saj jep projekte të shtetit për vaksinimin e çdo kafshe .Përdorimi pa kriteri i firmës dhe vulës jo vetëm dëmton shtetin por veçanërisht banorët pasi shpërthejnë sëmundje të ndryshme.
- Për dëmtimin ose humbjen e vulës njoftohet urgjentisht Njësia dhe Këshilli i bashkisë.
- Kryetari i fshatit në mungesë të zyrës dhe kasafortës duhet ta ruaj vulën, në një vend të sigurt dhe të garantuar.
- Në asnjë mënyrë nuk lejohet mbajtja e vulës në xhep pasi është shkelje ligjore.
- Mbajtja dhe përdorimi i vulës është kompetencë vetëm e kryetarit të kryesisë.

NENI 20

VAKANCA NË KRYESI.

Në rastet kur në kryesitë e fshatrave krijohen vakanca zgjedhjet bëhen konform zgjedhjeve të mëparshme me përfaqësues nga këshilli dhe bashkia .Zgjedhjet do të kryhen vetëm në lagjen ku është krijuar vakanca. Kur kemi vakancë të 2 anëtarëve të kryesisë brenda një fshati me 3 anëtarë kryesie,atëhere,jo vetëm bëhen zgjedhjet për 2 vendet e kryesisë,por edhe për kryetarin e fshatit.

NENI 21

PËRGJEGJËSITË DHE ZBATIMI I RREGULLORES

Për zbatimin e rregullores për strukturat komunitare në fshat përgjigjet këshilli i bashkisë dhe Njësia Administrative.
Pjesë e kësaj rregulloreje do të jetë dhe lista për të 36 fshatrat të ndara sipas Njësive dhe numri i kryesive me 3 dhe 5 anëtarë.
Njëkohësisht do të jenë pjesë e rregullores edhe shtojcat për vërtetimet tip që japin kryetarët e fshatrave për fakte të njohura botërisht .

NENI 22

NUMRAT E EMERGJENCËS

POLICIA-----129
SPITALI-----127
ZJARRFIKSJA-----128
SALLA OPERATIVE----- 033407546

NENI 23

HYRJA NË FUQI

Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Bashkisë dhe shprehjes së ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

**KRYESIA E FSHATRAVE TE BASHKISE VLORE
ME 3 ANETARE**

| Nr | Fshati | Emer | Mbiemer | Kontakt |
|-----------|-----------------------|-------------|----------------|----------------|
| 1. | <i>Dukat fshat</i> | | | |
| 2. | <i>Bestrova</i> | | | |
| 3. | <i>Shushica</i> | | | |
| 4. | <i>Aliban</i> | | | |
| 5. | <i>Bunavi</i> | | | |
| 6. | <i>Tragjas</i> | | | |
| 7. | <i>Babice e Vogel</i> | | | |
| 8. | <i>Beshisht</i> | | | |
| 9. | <i>Radhime</i> | | | |
| 10. | <i>Hoshtime</i> | | | |
| 11. | <i>Mifol</i> | | | |
| 12. | <i>Grabian</i> | | | |
| | | | | |

| | | | | |
|-----|-------------------|--|--|--|
| 13. | <i>Poro</i> | | | |
| 14. | <i>Drithas</i> | | | |
| 15. | <i>Dellenje</i> | | | |
| 16. | <i>Mekat</i> | | | |
| 17. | <i>Kerkove</i> | | | |
| 18. | <i>Trevllazer</i> | | | |
| 19. | <i>Llakatund</i> | | | |
| 20. | <i>Sherishte</i> | | | |
| 21. | <i>Cerkovine</i> | | | |
| 22. | <i>Çeprat</i> | | | |
| 23. | <i>Panaja</i> | | | |
| 24. | <i>Skrofotine</i> | | | |
| 25. | <i>Risili</i> | | | |
| 26. | <i>Xhyherine</i> | | | |
| | | | | |

| | | | | |
|-----|----------------|--|--|--|
| 27. | <i>Fitore</i> | | | |
| 28. | <i>Zvernec</i> | | | |
| 29. | <i>Delisuf</i> | | | |
| 30. | <i>Akerni</i> | | | |

**KRYESIA E FSHATRAVE TE BASHKISE VLORE
ME 5 ANETARE**

| NR | Fshati | Emer | Mbiemer | Kontakt |
|-----------|-----------------------|-------------|----------------|----------------|
| 1. | <i>Dukat fushe</i> | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| 2. | <i>Babice e Madhe</i> | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| 3. | <i>Kanine</i> | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| 4. | <i>Narte</i> | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| 5. | <i>Novosele</i> | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| 6. | <i>Bishan</i> | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____


VËRTETIM

Vërtetojmë se z-----i datëlindjes----- është banor
i fshatit-----.
E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesën e të interesuarit.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z ----- i datëlindjes-----
-- është banor i fshatit-----, Z-----është (vëllai ,motra nipi, nëna, babai etj.) i z----- i cili vuan dënimin në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të qytetit -----
-----.

Lëshohet ky vërtetim për efekt të takimit me z-----
- në këtë institucion.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z.----- i datëlindjes-----
është (nëna,babai,motra,vëllai,nipi, etj) i z.----- i cili
vuan dënimin në shtetin -----.
Lëshojmë këtë vërtetim për efekt të takimit me z----- në burgun
e -----.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z ----- është banor i fshatit -----

--


Dhe disponon një shtëpi banimi (2+1 ose 1+1 etj).

Lëshohet ky vërtetim për paraqitjen si dokument për OSHE.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z ----- është banor i fshatit -----


I datëlindjes -----, Në datën ----- ky person do të
tregtojë në qytetin ----- x kokë bagëti ose gjedh të cilat janë
pronë e tij.

Lëshojmë këtë vërtetim me kërkesën e të interesuarit .

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z ----- është banor i fshatit -----
-----,
Më datën ----- ky banor do të udhëtojë drejt qytetit -----

ku do të transportojë për të tregtuar dru ulliri të cilat janë krijuar nga krasitja e
ullishtes së tij.
Lëshohet ky vërtetim me kërkesën e të interesuarit.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z ----- i datëlindjes x ka
ndërruar jetë dhe është varrosur më datën----- pranë varrezave
të fshatit -----.

Lëshohet ky vërtetim për efekt dokumentacioni zyrtar.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

KRYETARI I FSHATIT _____

VLERËSIM SJELLJE
(karakteristikë)

Ju vemë në dijeni se z ----- i datëlindjes -----

është banor i fshatit ----- dhe ka reflektuar në vazhdimësi një sjellje korrekte. Në fshat nuk ka manifestuar shqetësime dhe sjellje të papëlqyeshme dhe nuk ka qenë shqetësim ose problematik për fshatin.etj

Por mund të jetë dhe e kundërta që x ka qenë problematik dhe shqetësim për fshatin.

Shënim: Këto vlerësime duhet të jenë objektive dhe jo të ndikohemi nga njohjet dhe miqësitë pasi mund të ndikojnë negativisht dhe agravojnë situatën e fshatit.

Vlerësime të tilla kërkohen kur një banor gjykata e nxjerr me masë arresti në shtëpi dhe shërbimi i provës kërkon vlerësim objektiv të banorit nga kryetari i kryesisë së fshatit.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM


Z ----- është banor i fshatit ----- i
datëlindjes ----- . Në bazë të ligjit 7501 ka përfituar tokë në fshatin

Lëshohet ky vërtetim për drejtorinë vendore të shërbimit të provës x.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë se z ----- është banor i fshatit -----

I cili me vendim të këshillit të bashkisë Vlorë me nr (x) datë (y) ka marrë pranë territorit të fshatit 300 ha kullotë në përdorim për një periudhë 3 vjeçare.

E lëshojmë këtë vërtetim për efekt dokumentacioni dhe kërkesë të të interesuarit.

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

Vërtetojmë që z----- banor i fshatit -----
është kufitar me kullotën e z----- të të njëjtit fshat,
E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesë të të interesuarit

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
KRYETARI I FSHATIT _____

VËRTETIM

KRYETARI I FSHATIT

(emër mbiemër)

(firma)